



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN**

Nr. _____ prot.

Elbasan me _____ .02. 2019

RELACION

“Mbi miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Elbasan

Z. Këshilltarë !

Hartimi i Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, bazohet në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor.

Gjithashtu, Tavanet Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, janë hartuar duke u bazuar në objektivat e zhvillimit të qytetit, të cilat lidhen me funksionet respektive të vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara në kuadrin ligjor. në nivel programi, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë njësi shpenzuese. Dokumenti i PBA-së, prezanton qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program, duke u fokusuar në programet më prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit.

Ky projekt afatmesëm bazohet në vizionin tonë për Elbasanin, i cili para së gjithash duhet të jetë një qytet lehtësisht i jetueshëm, me infrastrukturë moderne, me shërbime efikase dhe cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jetë kulturore e sportive të larmishme, me hapësira të gjelbërta të dedikuara për fëmijët dhe të moshuarit. Ne jemi të bindur se paverësisht problemeve të shumta, qyteti i Elbasanit mbart një potencial të konsiderueshëm ekonomik, social e kulturor.

Objektivi themelor i këtij Programi Afatmesëm është përmirësimi në vazhdim i cilësisë së jetesës në qytetin e Elbasanit, nëpërmjet mbrojtjes së mjedisit, rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollorë, përmirësimin të kushteve në çerdhe, kopështe e shkolla, ofrimit të shërbimeve sociale cilësore, rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale, turizmit, etj.

Parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve është bazuar në:

1. Paketën fiskale të Bashkisë së Elbasan, miratuar me vKB nr.144, datë 22.11.2018.
2. Shpërndarjen e burimeve në përputhje me prioritetet e zhvillimit të qytetit.
3. Prioritetet e qytetarëve të evidentuara gjatë takimeve në çdo njësi administrative,

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i taveve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, janë :

- Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit;
- Garantimi i pastërtisë së qytetit dhe i cilësisë së ajrit;
- Ofrimin e shërbimeve cilësore;
- Përmirësimin e infrastrukturës arsimore;
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore;
- Nxitjen dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, të cilat ndikojnë në shëndetin e popullatës;
- Gjallërimi i jetës kulturore dhe artistike, nëpërmjet mbështetjes së projekteve;
- Mbështetja e trashëgimisë kulturore dhe e turizmit.

Në çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet, duke përfshirë funksionet e veta dhe funksionet specifike, sipas llojit dhe njësive shpenzuese, ku përfshihen :

Shpenzimet :

- a. Shpenzimet korente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, interesa);
- b. Shpenzimet kapitale

Njësitë Shpenzuese :

1. Aparati i Administratës së Bashkisë
2. Qendra Ekonomike e Arsimit
3. Sport Klub Elbasani
4. Ndërmarrja Mirëmbajtje Terrene Sportive
5. Qendra e Artit
6. Qendra e Trashëgimisë Kulturore
7. Agjensia e Shërbimeve Publike
8. Qendra Sociale “Balashe”
9. Njësia e Menaxhimit të Banesave Sociale

Treguesit ekonomikë e finciarë të Bashkisë Elbasan për periudhën 2020-2022, janë bazuar në burimet e planifikuara në “Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitet 2020-2022” dhe në kërkesat e rishikuara buxhetore për këtë periudhë.

Sipas këtij materiali, të ardhurat e parashikuara për periudhën 2020-2022, në mijë lekë, janë :

Të ardhurat	2020	2021	2022
Tatimore	705,579	719,031	733,411
Jo tatimore	615,949	628,268	640,834
Transferta e pakushtëzuar	722,288	765,374	795,989
Transferta specifike	413,440	413,440	413,440
Të ardhura jasht limiti	5,800	5,860	5,925
Totali :	2,463,056	2,531,973	2,589,599

Si bazë për parashikimin e të ardhurave ka shërbyer vendimi i Këshillit Bashkiak nr.162, datë 24.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019”, tabela nr.2/1 “Parashikimi i të ardhurave të Bashkisë Elbasan për periudhën 2019-2021” si dhe ndryshimet e reflektuara në “Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për vitet 2020-2022”.

Në krahasim me vitin 2019 është parashikuar një rritje e të ardhurave me 2% nga viti në vit. Gjithashtu, në planifikimin e periudhës 2020-2022 është marrë në konsideratë rritja e planit të të ardhurave të vitit 2019 për shumën 34 milion lekë, taksë e ndikimit në infrastrukturë dhe taksë mbi ndërtesat, miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimin nr.9, datë 24.01.2019.

Tavanet e Shpenzimeve:

Ndryshe nga vitet e mëparshme, shpenzimet janë përshtatur sipas strukturës së re të programeve buxhetore. Si bazë për parashikimin e taveve të shpenzimeve ka shërbyer vendimi i Këshillit Bashkiak nr.162, datë 24.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan, për vitin 2019”, tabela nr.2 “Tavanet e shpenzimeve për periudhën 2019-2021”, duke ruajtur të njëjtin nivel të rritjes së shpenzimeve edhe për vitin 2022.

Shpenzimet administrative janë planifikuar me ulje nga viti në vit, kryesisht ato për administratën, ndërkohë që është planifikuar të jenë me rritje shpenzimet për shërbimet publike si: pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi rrugor, mirëmbajtja e rrugëve në qytet dhe në zonat rurale, mirëmbajtja e ambjentëve arsimore, shërbimet sociale, etj.

Përsa i takon shpenzimeve për personelin, për periudhën 2020-2022 është parashikuar të ruhet i njëjti nivel i pagave, me një rritje rreth 2% e fondit për këtë zë shpenzimi në rast të rritjes së pagës minimale apo të pagës së grupit.

Investimet janë përqëndruar kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës, kryesisht asaj rrugore dhe shërbimet publike, pa lënë mënjanë programet e tjera, duke synuar për një shtrirje të investimeve në të gjitha aspektet.

Gjithashtu, në programin “Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike” është reflektuar vendimi i Këshillit Bashkiak nr.9, datë 24.01.2019 “Rikualifikimi urban i Teatrit “Skampa”, duke rritur në shumën 33 milion lekë investimet për vitin 2020 dhe po në këtë shumë për vitin 2021, periudhë në të cilën përfundon objekti.

Pjesa e mbetur nga huaja është planifikuar të disbursohet gjatë vitit 2019, e për këtë arsye nuk është pjesë e programit për tre vitet e ardhshme.

Totali i shpenzimeve të Bashkisë Elbasan (korente dhe kapitale), në mijë lekë, për çdo program, bazuar në të ardhurat e veta dhe grantet (i pakushtëzuar dhe specifik), është si më poshtë :

Programi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1. Planifikim, Menaxhim, Administrim	380,609	388,221	385,986
2. Çështjet Financiare dhe Fiskale	79,350	80,937	86,619
3. Gjendjet Civile	700	700	704
4. Pagesa për shërbimin e borxhit	120,916	123,334	123,334
5. Shërbimet e Policisë Vendore	31,212	31,836	33,173
6. Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	55,064	56,165	58,789
7. Mbështetje për zhvillimin ekonomik	-	-	1,200
8. Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi ...	7,177	17,321	17,667
9. Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, ...	19,360	19,747	20,142
10. Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes	37,038	37,779	38,534
11. Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	53,119	54,181	55,265
12. Rrjeti Rrugor Rural	412,178	420,422	428,830
13. Transporti Publik	33,540	34,211	34,895
14. Menaxhimi i Mbetjeve	106,384	113,512	125,782
15. Menaxhimi Ujrave të Zeza, Kanalizimet	32,847	33,504	34,174
16. Programe te Mbrojtjes Mjedisit	1,382	6,782	6,917
17. Planifikimi Urban Vendor	204	208	212
18. Shërbimet Publike Vendore	211,077	215,299	219,605
19. Furnizimi me Ujë	17,022	17,362	27,710
20. Ndriçim Rrugësh	100,038	102,039	104,080
21. Shërbimet e Kujdesit Parësor	3,151	3,214	3,278
22. Sport dhe Argëtim	47,330	48,277	59,242
23. Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike	106,403	107,829	79,986
24. Arsimi Bazë (+ parashkollor)	400,316	408,322	416,489

25. Arsimi Mesëm Përgjithshëm	52,192	53,236	63,301
26. Arsimi Profesional	43,908	44,786	45,682
27. Kujdesi Soc.për personat e sëmurë & aftësi...	3,400	3,468	3,537
28. Sigurimi Shoqëror (të moshuarit)	9,022	9,202	10,386
29. Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët	73,587	75,059	76,560
30. Strehimi Social	6,530	6,661	8,794
31. Fondi Rezervë dhe Kontigjenca	18,000	18,360	18,727
Totali Programeve :	2,463,056	2,531,973	2,589,599

Ky dokument, hartimi i Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, për Bashkinë Elbasan, është hartuar nga administrata e Bashkisë, nëpërmjet “Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

Programi Buxhetor Afatmesëm është instrumenti më i rëndësishëm i menaxhimit financiar, i cili synon integrimin e programit të Bashkisë Elbasan me nevojat e qytetarëve dhe që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korente dhe kapitale për periudhën 2020 -2022, duke prezantuar politikën financiare afatmesme të Bashkisë.

Gjithashtu, ky program u shërben të gjitha njësive shpenzuese pasi përcakton në mënyrë të qartë politikën për çdo program dhe u jep mundësi të përcaktojnë kostot dhe prioritetet e tyre për çdo aktivitet, brenda kontekstit të mundësive të disponueshme financiare.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZV/ KRYETARI
Klevis Xhoxhi



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ prot.

Elbasan më ____ .02. 2019

RELACION

MBI

“VLERSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR
VITET 2020-2022

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Elbasan

Z. Këshilltarë !

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Elbasan është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to dhe Paketën fiskale të Bashkisë Elbasan për vitin 2019, miratuar me VKB nr. 144, datë 22.11.2018.

Si rrjedhim i këtyre politikave, të ardhurat e Bashkisë Elbasan për vitin 2020, paraqiten me një rritje prej 2% në krahasim me vitin 2019, e po kështu për vitet 2021 e 2022 mendohet të kenë të njëjtën rritje përkatësisht me 2% më shumë se viti respektiv i mëparshëm.

Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë, por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave.

Parashikimi i të ardhurave për këtë periudhë afatmesme parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

- Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse &tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëttimeve;

Struktura e të Ardhurave për periudhën 2020-2022 :

Në mijë lekë

<u>Të ardhurat</u>	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Tatimore	705,579	719,031	733,411
Jo tatimore	615,949	628,268	640,834
Transferta e pakushtëzuar	722,288	765,374	795,989
Transferta specifike	413,440	413,440	413,440
Të ardhura jasht limiti	5,800	5,860	5,925
Totali :	2,463,056	2,531,973	2,589,599

Burimet e financimit të buxhetit për Bashkinë Elbasan, përbëhen nga:

I. Të ardhurat e veta:

- a) Të ardhurat nga taksat
- b) Të ardhurat nga tarifaf
- c) Të ardhurat nga njësitë e varësisë
- d) Te ardhurat jasht limitit;

II. Transferta e pakushtëzuar.

III. Transferta e pakushtëzuar sektoriale (granti specifik);

IV. Huamarrja e qeverisjes vendore;

Për vitin 2020 është llogaritur që të ardhurat nga taksat e tarifaf vendore të arrijnë në shumën 1,321,528 mijë lekë, me një rritje prej 2% në krahasim me planin e vitit 2019 (viti 2019= 1,342,381 - 45,000 të ardhura nga shitja e aksioneve). Kjo rritje vjen edhe për arsye të rishikimit të kapacitetit të taksave e tarifave, duke identifikuar me saktësi subjektet që duhet të likuidojnë këto detyrime.

Për vitin 2020, vlera e transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë e Elbasanit parashikohet në shumën 722,288 mijë lekë ose 7.3 % më e lartë se transferta e pakushtëzuar e akorduar për vitin 2019, ndërsa për transfertën specifike parashikohet të ruhet i njëjti nivel i financuar për vitin 2019, që është në vlerën 413,440 mijë lekë.

Huaja e mbetur pa disbursuar, e cila është në vlerën 91,837 mijë lekë është parashikuar të disbursohet gjatë vitit 2019, e për këtë arsye nuk është mbartur në vitet 2020-2022. Nese do të ndodhë të mos disbursohet gjatë vitit 2019, atëherë do të jetë pjesë e financimit të buxhetit 2020-2022.

Treguesit ekonomikë e financiarë të Bashkisë Elbasan për periudhën 2020-2022, paraqiten në tabelën si më poshtë :

Në mijë lekë

EMERTIMI	PARASHIKIM 2020	PARASHIKIM 2021	PARASHIKIM 2022
Te ardhura nga taksat	618,267	629,973	642,572
Taksa vendore mbi veprimt. ekonom. te biznesit vogel	240	244	249
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e BV	8,747	8,921	9,100
Taksa mbi ndertesat	192,900	196,758	200,694

Taksa mbi token bujqesore	30,600	31,212	31,836
Taksa mbi truallin	28,451	29,020	29,600
Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	11,743	11,978	12,218
Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	343,980	350,200	357,204
Taksa e tabelës	1,607	1,639	1,671
Te ardhura nga taksat e ndara	87,312	89,058	90,839
Taksa e kalimit te se drejtes se pronesise per pasurite palujtsh.	10,710	10,924	11,143
Taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura	56,100	57,222	58,366
Renta minerare	102	104	106
Tatimi mbi te ardhurat personale	20,400	20,808	21,224
Te ardhura nga tarifat	378,464	386,033	393,754
Tarife zenie hapës.publike (tregu)	30,600	31,212	31,836
Tarife zenie hapës.publike (tavolina + zenie hapësire)	29,114	29,696	30,290
Tarife pastrimi	142,800	145,656	148,569
Tarife gjelberimi	32,629	33,281	33,947
Tarife ndricimi	40,776	41,591	42,423
Tarife reklame	19,380	19,768	20,163
Tarife veterinare	3,402	3,470	3,539
Tarife gjuetie	5	5	5
Tarife parkimi	17,850	18,207	18,571
Tarife embleme	105	107	109
Tarife regjistrimi	40	41	41
Tarife leje certifikate transporti	1,993	2,033	2,074
Tarife per autorizim karburanti	3,338	3,405	3,473
Tarife per vertetime	2,391	2,439	2,487
Tarife dokumenta ankandi	20	21	21
Tarife zgjatje orari	1,122	1,144	1,167
Tarife formulare te pastrehe	33	33	34
Tarife karrotrec	326	333	340
Tarife leje perdorimi per objekte biznesi	14,280	14,566	14,857
Tarife leje perdorimi per objekte banimi	1,928	1,966	2,006
Tarife certifikim relievi	816	832	849
Tarife deklarim paraprak	1,020	1,040	1,061
Tarife fasade	1,224	1,248	1,273
Tarife leje shfrytezimi	102	104	106
Tarife shqyrtim dok.leje ndertimi	1,691	1,725	1,759
Tarife sherbim dhe shqyrtim dokumentacioni	2	2	2
Tarife kantier ndertimi	2,550	2,601	2,653
Tarife dokumenta nga arkiva	265	271	276
Tarife rrjeti tubacioneve te ujrave te bardha	5,100	5,202	5,306
Tarife rrjeti tubacioneve te ujrave te zeza	2,040	2,081	2,122
Tarife rrjeti kabllor	4,080	4,162	4,245
Tarife uji i pijshem	612	624	637
Tarife autorizim lende djegese	510	520	531
Tarife ndotje mjedisi	16,320	16,646	16,979
Te ardhura te tjera	150,170	153,173	156,236
Privatizim banese	0	0	0
qera pajisje	44	45	46
qera objekti	1,393	1,421	1,450
qera trualli	107	109	111
qera trualli (operatorët televizive)	2,357	2,404	2,452

qera toke bujqesore	408	416	424
gjoba ndertimi	10,200	10,404	10,612
gjoba biznesi	9,180	9,364	9,551
te ardhura nga legalizimet	126,480	129,010	131,590
Te ardhura nga institucionet vartese	74,055	75,537	77,048
Kopeshte (QEA)	37,698	38,453	39,222
Çerdhe (QEA)	11,310	11,536	11,767
Qera objekti (QEA)	9,127	9,309	9,496
Klubi Shumesporte	1,028	1,049	1,070
Qendra e Artit	918	936	955
Trashegimia Kulturore	102	104	106
Sherbimet Publike	6,222	6,346	6,473
Menaxhimi Banesave Sociale	7,650	7,803	7,959
Te ardhura nga funksionet specifike	13,260	13,525	13,796
Tarifa sherbimi te MZSH	0		
Tarifa te sherbimit pyjor	10,200	10,404	10,612
Tafifa nga ujitja dhe kullimi	3,060	3,121	3,184
Totali I :	1,321,528	1,347,299	1,374,245
Te ardhura nga huaja	0	0	0
Transferta e pakushtezuar	722,288	765,374	795,989
Transferta specifike	413,440	413,440	413,440
Totali II	2,457,256	2,526,113	2,583,674
Te ardhura jasht limiti	5,800	5,860	5,925
Takse pulle (agjent tatimor)	700	700	704
Sponsorizim	3,000	3,060	3,121
Transferta K.Qarkut	2,100	2,100	2,100
Gjithsej te ardhurat :	2,463,056	2,531,973	2,589,599

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZV/ KRYETARI
Klevis Xhoxhi

Bashkia Elbasan
Programi Buxhetor Afatmesem 2020-2022

Tavanet per gatitore te shpenzimeve per vitet 2020-2022

ne 000/leke

Nr	Emertimi programit	Programi	Viti 2020				Viti 2021				Viti 2022		
			Shpenzime personeli	Shpenzime tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali programit	Shpenzime personeli	Shpenzime tjera korente	Shpenzime Kapitale	Totali buxhetit	Shpenzime personeli	Shpenzime tjera korente	Shpenzime Kapitale
1	Planifikim Menaxhim & Administrim	01110	236,839	113,454	30,316	380,609	241,576	115,723	30,922	388,221	246,407	118,038	21,541
2	Çeshtje financiare dhe fiskale	01120	71,850	7,500	0	79,350	73,287	7,650	0	80,937	74,753	7,803	4,063
3	Gjendja Civile	01170		700		700		700		700		704	
4	Pagesa per sherbimin e borxhit te brends	01710	0	120,916	0	120,916	0	123,334	0	123,334	0	123,334	0
4	Sherbimet e Policise Vendore	03140	29,224	1,988	0	31,212	29,808	2,028	0	31,836	30,405	2,068	700
6	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	03280	27069	27,871	124	55,064	27,610	28,428	126	56,165	28,163	28,997	1,629
7	Mbeshtetje per zhvillim ekonomik	04130				0	0	0	0	0	0	0	1,200
8	Sherbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspe	04160	0	0	7,177	7,177	0	0	17,321	17,321	0	0	17,667
9	Sherbimet bujqesore, inspektimi, siguria	04220	0	0	19,360	19,360	0	0	19,747	19,747	0	0	20,142
10	Menazhimi i infrastruktures se ujitjes dh	04240	10,589	10663	15,786	37,038	10,801	10,876	16,102	37,779	11,017	11,094	16,424
11	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	04260	27,891	18,593	6,635	53,119	28,449	18,965	6,768	54,181	29,018	19,344	6,903
12	Rrjeti rrugor rural	04520	46,825	24,592	340,761	412,178	47,762	25,084	347,576	420,422	48,717	25,586	354,528
13	Transporti publik	04570	14,485	19,055	0	33,540	14,775	19,436	0	34,211	15,070	19,825	0
14	Menaxhimi i mbetjeve	05100	9,857	90,827	5,700	106,384	10,054	92,644	10,814	113,512	10,255	94,496	21,030
15	Menaxhimi i ujrave te zeza dhe kanalizim	05200	0	0	32,847	32,847	0	0	33,504	33,504	0	0	34,174
16	Programe te mbrojtjes se mjedisit	05320	0	1,282	100	1,382	0	1,308	5,474	6,782	0	1,334	5,583
17	Planifikimi urban vendor	06140	0	0	204	204	0	0	208	208	0	0	212
18	Sherbimet publike vendore	06260	40,700	85,988	84,389	211,077	41,514	87,708	86,077	215,299	42,344	89,462	87,798

19	Furnizimi me uje	06330	0	0	17,022	17,022	0	0	17,362	17,362	0	0	27,710
20	Ndriçim rrugesh	06440	4,930	83,506	11,602	100,038	5,029	85,176	11,834	102,039	5,129	86,880	12,071
21	Sherbimet e kujdesit paresor	07220	560	300	2,291	3,151	571	306	2,337	3,214	583	312	2,384
22	Sport dhe argetim	08130	26,040	21,240	50	47,330	26,561	21,665	51	48,277	27,092	22,098	10,052
23	Trashegimia kulturore, eventet artistike e	08220	41,320	27,280	37,803	106,403	42,146	27,784	37,899	107,829	42,989	28,339	8,657
24	Arsimi baze (perfshire parashkollor)	09120	280,600	79,868	39,848	400,316	286,212	81,465	40,645	408,322	291,936	83,095	41,458
25	Arsimi mesem pergjithshem	09230	32192	20,000	0	52,192	32,836	20,400	0	53,236	33,493	20,808	9,000
26	Arsimi profesional	09240	8350	9,096	26462	43,908	8,517	9,278	26,991	44,786	8,687	9,463	27,531
27	Kujdesi social per personat e semure & a	10140	0	3,400	0	3,400	0	3,468	0	3,468	0	3,537	0
28	Sigurimi shoqeror (te moshuarit)	10220	3,755	5,000	267	9,022	3,830	5,100	272	9,202	3,907	5,202	1,278
29	Kujdesi social per familjet dhe femijet	10430	44,292	27,964	1,331	73,587	45,178	28,523	1,358	75,059	46,081	29,094	1,385
30	Strehimi social	10661	4,450	1,880	200	6,530	4,539	1,918	204	6,661	4,630	1,956	2,208
31	F.Rezerve & Kontigjenca	04980	0	18,000	0	18,000	0	18,360	0	18,360	0	18,727	0
	Gjithsej :		961,818	820,963	680,275	2,463,056	981,054	837,326	713,593	2,531,973	1,000,675	851,596	737,327

Totali buxhetit
385,986
86,619
704
123,334
33,173
58,789
1,200
17,667
20,142
38,534
55,265
428,830
34,895
125,782
34,174
6,917
212
219,605

27,710
104,080
3,278
59,242
79,986
416,489
63,301
45,682
3,537
10,386
76,560
8,794
18,727
2,589,599

VLERESIMET DHE RASHIKIMET AFATMESME TE TE ARDHURAVE TE BASHKISE ELBASAN PER PERIUDHEN 2017-2022

ne mije leke

	EMERTIMI	FAKT 2017	Fakt 2018	Plan 2019	PARASHIKIMI 2020	PARASHIKIMI 2021	PARASHIKIMI 2022
A	Te ardhura nga taksat	209,154	235,906	607,909	618,267	629,973	642,572
1	Taksa vendore mbi veprimtarine ekonom.te biznesit te vogel	152	215	235	240	244	249
2	Tatimi I thjeshtuar mbi fitimin e BV	7,627	7,869	8,575	8,747	8,921	9,100
3	Taksa mbi ndertesat	128,623	135,516	189,118	192,900	196,758	200,694
4	Taksa mbi token bujqesore	22,890	22,114	30,000	30,600	31,212	31,836
5	Taksa mbi truallin	12,983	28,071	27,893	28,451	29,020	29,600
6	Taksa mbi veprimtarine e sherbimit hotelier	6,696	10,891	11,513	11,743	11,978	12,218
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	29,457	30,482	339,000	343,980	350,200	357,204
8	Taksa e tabelës	726	748	1,575	1,607	1,639	1,671
B	Te ardhura nga taksat e ndara	47,790	62,487	85,600	87,312	89,058	90,839
1	Taksa e kalimit te se drejtes se pronesise per pasurite e palujtshme	10,043	9,681	10,500	10,710	10,924	11,143
2	Taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura	36,486	52,708	55,000	56,100	57,222	58,366
3	Renta minerare	1,261	98	100	102	104	106
4	Tatimi mbi te ardhurat personale	0	0	20,000	20,400	20,808	21,224
	Te ardhura nga tarifat	252,305	295,057	371,043	378,464	386,033	393,754
	Tarife zenie hapës.publike (tregu)	8,300	10,341	30,000	30,600	31,212	31,836
	Tarife zenie hapës.publike (tavolina + zenie hapësire)	14,949	20,227	28,543	29,114	29,696	30,290
	Tarife pastrimi	102,771	139,661	140,000	142,800	145,656	148,569
	Tarife gjelberimi	22,271	30,491	31,989	32,629	33,281	33,947
	Tarife ndricimi	25,065	37,557	39,976	40,776	41,591	42,423
	Tarife reklame	16,262	12,532	19,000	19,380	19,768	20,163
	Tarife veterinare	1,066	3,414	3,335	3,402	3,470	3,539
	Tarife gjuetie	4	2	5	5	5	5
	Tarife parkimi	11,591	6,999	17,500	17,850	18,207	18,571
	Tarife embleme	41	99	103	105	107	109
	Tarife regjistrimi	69	36	39	40	41	41
	Tarife leje certifikate transporti	4,135	2,037	1,954	1,993	2,033	2,074
	Tarife per autorizim karburanti	17,000	3,000	3,273	3,338	3,405	3,473
	Tarife per vertetime	2,368	2,255	2,344	2,391	2,439	2,487
	Tarife dokumenta ankandi	0	0	20	20	21	21
	Tarife zgjatje orari	884	578	1,100	1,122	1,144	1,167
	Tarife formulare te pastrehe	51	31	32	33	33	34
	Tarife karrotrec	153	69	320	326	333	340
	Tarife leje perdorimi per objekte biznesi	2,021	1,450	14,000	14,280	14,566	14,857
	Tarife leje perdorimi per objekte banimi	1,656	1,084	1,890	1,928	1,966	2,006
	Tarife certifikim relievi	624	608	800	816	832	849
	Tarife deklarim paraprak	923	765	1,000	1,020	1,040	1,061
	Tarife fasade	524	1,310	1,200	1,224	1,248	1,273
	Tarife leje shfrytezimi	0	0	100	102	104	106
	Tarife shqyrtim dok.leje ndertimi	825	1,715	1,658	1,691	1,725	1,759
	Tarife sherbim dhe shqyrtim dokumentacioni	145	2	2	2	2	2
	Tarife kantier ndertimi	2,040	2,450	2,500	2,550	2,601	2,653
	Tarife dokumenta nga arkiva	199	131	260	265	271	276
	Tarife rrjeti tubacioneve te ujrave te bardha	2,203	0	5,000	5,100	5,202	5,306
	Tarife rrjeti tubacioneve te ujrave te zeza	303	0	2,000	2,040	2,081	2,122
	Tarife rrjeti kabllor	597	994	4,000	4,080	4,162	4,245
	Tarife uji i pjshem	62	197	600	612	624	637
	Tarife autorizim lende djegese	4,698	0	500	510	520	531
	Tarife ndotje mjedisi	8,505	15,022	16,000	16,320	16,646	16,979
	Te ardhura te tjera	72,570	39,672	192,225	150,170	153,173	156,236
	Privatizim banese	17	0	0	0	0	0
	qera pajisje	117	39	43	44	45	46
	qera objekti	2,885	1,348	1,366	1,393	1,421	1,450
	qera trualli	80	93	105	107	109	111
	qera trualli (operatoret televizive)	930	2,255	2,311	2,357	2,404	2,452
	qera toke bujqesore	404	312	400	408	416	424
	gjoba ndertimi	1,919	1,124	10,000	10,200	10,404	10,612
	gjoba biznesi	6,613	9,363	9,000	9,180	9,364	9,551
	te ardhura nga legalizimet	54,605	25,138	124,000	126,480	129,010	131,590
	Te ardhura nga shitja e aksioneve (FK Elbasani)	5,000		45,000			

Te ardhura nga institucionet vartese	43,544	46,941	72,604	74,055	75,537	77,048	
Kopeshte (QEA)	19,896	21,255	36,960	37,698	38,453	39,222	
Çerdhe (QEA)	4,109	4,910	11,088	11,310	11,536	11,767	
Qera objekti (QEA)	4,313	6,227	8,948	9,127	9,309	9,496	
Klubi Shumesporte	1,075	1,051	1,008	1,028	1,049	1,070	
Qendra e Artit	1,449	662	900	918	936	955	
Trashegimia Kulturore	59	63	100	102	104	106	
Sherbimet Publike	5,566	5,711	6,100	6,222	6,346	6,473	
Menaxhimi Banesave Sociale	7,077	7,062	7,500	7,650	7,803	7,959	
Te ardhura nga funksionet specifike	16,282	9,060	13,000	13,260	13,525	13,796	
Tarifa sherbimi te MZSH	0	0	0	0			
Tarifa te sherbimit pyjor	13,490	7,637	10,000	10,200	10,404	10,612	
Tafifa nga ujitja dhe kullimi	2,792	1,423	3,000	3,060	3,121	3,184	
Totali I :	641,645	689,123	1,342,381	1,321,528	1,347,299	1,374,245	
Te ardhura nga huaja	23,637	3,802	91,837	0	0	0	
Transferta e pakushtezuar	576,731	636,618	673,776	722,288	765,374	795,989	
Transferta specifike	377,910	398,045	413,440	413,440	413,440	413,440	
Te ardhura te trasheguara 2018	207,432	280,877	193,582				
Totali II	1,827,355	2,008,465	2,715,016	2,457,256	2,526,113	2,583,674	
Te ardhura jasht limiti	4,777	2,763	6,840	5,800	5,860	5,925	
Takse pulle (agjent tatimor)	847	663	700	700	700	704	
Sponsorizim	0		1,140	3,000	3,060	3,121	
Transferta K.Qarkut	3,930	2,100	5,000	2,100	2,100	2,100	
Gjithsej te ardhurat :	1,832,132	2,011,228	2,721,856	2,463,056	2,531,973	2,589,599	



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK I QYTETIT ELBASAN

Nr. _____ Prot.

Datë ____ .03. 2019

VENDIM

NR. _____, DATË ____ .03. 2019

MBI

**“TAVANET PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE, TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2020-2022”**

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan i mbledhur sot më datë ____ . 03. 2019, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, “Mbi tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2020-2022”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI :

1. Miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2020-2022, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Klajdi GRIPSHI

ZV/ KRYETARI
Alketa Ipeku



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK I QYTETIT ELBASAN**

Nr. _____ Prot.

Datë ____ .03. 2019

VENDIM

**NR. _____, DATË _____ . 03. 2019
MBI**

**“VLERSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TE TE ARDHURAVE PER VITET
2020-2022**

Keshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan i mbledhur sot me date ____ 03. 2019, pasi mori ne shqyrtim materialet e pergatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim te Kryetarit te Bashkise Elbasan, “Mbi vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave per vitet 2020-2022”, mbeshetur ne ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, date 27.04.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”,

VENDOSI :

1. Miratimin e raportit per vleresimet dhe parashikimet afatmesme te te ardhurave te Bashkise Elbasan per dy vitet para vitit buxhetor, vitin buxhetor dhe tre vitet e ardhshme 2020-2022, sipas materialit bashkengjitur ketij vendimi.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Grupi per Menaxhimin Strategjik.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

**SEKRETARI
Klajdi GRIPSHI**

**ZV/ KRYETARI
Alketa Ipeku**